REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot. Tiranë, më ___.___.2022

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 14.11.2022)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 11:37 dhe mbaroi në orën 11:49.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. ***Ilir Rusi*** ***(zëvendëskryetar)***
2. ***Klodian Kurushi*** ***(anëtar)***
3. ***Fatmira Luli*** ***(anëtare)***
4. ***Dritan Hallunaj*** ***(anëtar)***
5. ***Ridvan Hado*** ***(anëtar)***
6. ***Alban Toro*** ***(anëtar)***
7. ***Marçela Shehu*** ***(anëtare)***
8. ***Brikena Ukperaj*** ***(anëtare)***

Shënim: Nuk mori pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Naureda Llagami***, anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Yllka Rupa*** dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, ***znj. Irena Plaku***.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. Luan Dibra, Drejtor i Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Denisa Varfi dhe Entela Dobi, përfaqësuese të Ministrisë së Drejtësisë.

4. Staf administrativ i KLGJ-së, Media KLGJ.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit "Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme", i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).[1]

Çështja e cila është për trajtim në rendin e ditës së datës 14.11.2022, ora 11:30 lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, z. Klodian Kurushi për të relatuar relacionet e përgatitura nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Zoti Kurushi delegon zonjën Alicanaj që të vijojë me relatimin e të gjitha relacioneve për secilën nga kërkesat e paraqitura nga gjykatat që janë në nevojë.

Zonja Alicanaj merr fjalën duke parashtruar se nga ana e Komisionit të Zhvillimit të Karrierës është hartuar relacioni "Për caktim gjyqtari në Gjykatën e Apelit Korçë", pasi deri në datën 14 nëntor kanë ardhur për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta nga ana e zëvendëskryetares së kësaj gjykate.

Shkurtimisht, **<u>Gjykata e Apelit Korçë</u>** ka paraqitur nevojë në 4 çështje, në lënde penale (lexohen të dhënat e çështjeve që do t'i nënshtrohen procedurës së shortit sipas tabelës në relacion). Për çështjen me numër rendor 1 në tabelë kërkohet caktimi i një gjyqtari; Për çështjen me numër rendor 2 në tabelë kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve pasi gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Korçë kanë disponuar me vendim për "Vleftësim arresti në flagrancë"; Për çështjen me numër rendor 3 në tabelë kërkohet caktimi i një gjyqtari; Për çështjen me numër rendor 4 në tabelë kërkohet caktimi i tre gjyqtarëve pasi gjyqtarët që ushtrojnë funksionin në Gjykatën e Apelit Korçë kanë disponuar me vendimin nr. 39, datë 19.03.2021 me objekt: "Caktim mase sigurimi".

[1] Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Apelit Korçë, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i nenit 170/1, të Ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe vendimit të KLGJ-së "Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme".

Propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen, me short, gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë Gjykata e Apelit Tiranë.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 4 çështjeve gjyqësore të veçanta, të jetë 3.

Propozimet vijuese të Komisionit janë:

Në shortimin e çështjeve, të përjashtohet nga shorti kryetarja në detyrë e Gjykatës së Apelit Tiranë, konkretisht: znj; {...}, si edhe znj. {...} për shkak të lejes së miratuar me vendim të kryetarit të gjykatës deri më 30.11.2022.

Zonja Ukperaj merr fjalën duke u shprehur se në mbledhjen e kaluar u propozua prej saj përjashtimi edhe të zonjës {...} nga procedurat e shortit në gjykata të tjera. Zonja Ukperaj parashtron se vazhdon t'i mbetet këtij propozimi për arsyet si vijon: Me vendimin nr. 30, datë 14.02.2019 (ndryshuar me vendimin nr.140, me vendimin nr. 126, datë 06.03.2020), KLGJ-ja në pikën 8 të këtij vendimi ka parashikuar rastet dhe përjashtimet e gjyqtarëve nga caktimi për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë në një gjykatë tjetër të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme. Gjyqtarët që përjashtohen janë evidentuar në pika të veçanta në këtë Kre të veçantë të vendimit dhe janë konkretisht: gjyqtarët që kanë një pengesë ligjore për të gjykuar çështjen gjyqësore të veçantë (ku zonja {...} nuk përfshihet); kryetari i gjykatës respektive (rrethi gjyqësor ose apelit) i cili për shkak të përgjegjësive të tjera që vijojnë nga ushtrimi i funksionit respektiv, si rregull është thënë në vendim, përjashtohet nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t'u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. Përjashtimisht, për arsye objektive, ai përfshihet në listat e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në masën 50% të volumit të çështjeve (Kreu VIII, pika 3). Nga ana e Komisionit duket që ky parashikim është zbatuar për zonjën {...}, duke e përjashtuar dhe është dakord.

Veç këtij përjashtimi ka edhe një përjashtim tjetër. Thuhet në vendim: “5. Gjyqtari anëtar i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, për shkak të përgjegjësive të tjera që vijnë nga ushtrimi i funksionit respektiv, si rregull, përjashtohen nga kualifikimi si gjyqtar që plotëson kriteret për t’u caktuar për gjykimin e një çështjeje gjyqësore të veçantë. ...”. Për këtë gjyqtar nuk është e nevojshme paraqitja e kërkesës por rregulli që zbaton Këshilli është ai i përjashtimit ashtu sikundër edhe për kryetarin e gjykatës. Edhe për anëtarin e Emërimeve në Drejtësi, sikundër për kryetarin e gjykatës ka një përjashtim: “Përjashtimisht, për arsye objektive, përfshihet në listat e gjyqtarëve që caktohen për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në masën 50% të volumit të çështjeve.” Si zonja {...} edhe zonja {...} ndodhen përpara kushteve të njëjta të përjashtimit nga lista e gjyqtarëve që caktohen për t’u gjykuar në gjykatën e Apelit Korçë.

Për këtë arsye, bazuar në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 30, datë 14.02.2019, konkretisht, kreu VIII, pika 5, propozoj përsëri që zonja {...}, për sa kohë vazhdon të ushtrojë funksionin e anëtares së Kolegjit Zgjedhor dhe jo më vonë se nesër është pikërisht një mbledhje e këtij Këshilli sipas të dhënave të faqes së Gjykatës së Lartë dhe për shkak të angazhimit që ajo ka këto dy muaj për plotësimin e vakancave në Gjykatën Kushtetuese, vlerësoj që edhe ajo sikundër kryetarja e gjykatës duhet të përjashtohet nga lista e gjyqtarëve të kualifikuar për t’u caktuar në Gjykatën e Apelit Korçë.

Zoti Rusi fton anëtarët për diskutime të tjera në lidhje me propozimin e bërë nga zonja Ukperaj, por duke qenë se nuk ka diskutime nga anëtarët, ndodhur në këto rrethana, hidhet në votim propozimi i ardhur nga zonja Ukperaj që sikundër kryetarja në detyrë, të përjashtohet nga shorti edhe zonja {...} për shkak të të njëjtave parashikime në vendimin e Këshillit të Lartë Gjyqësor:

Zoti Hallunaj: Kundër.

Zoti Hado: Kundër me arsyetimin që: Herën e kaluar ka votuar pro heqjes nga shorti të zonjës {...} për arsye të të qenit online dhe vala nuk vinte në rregull, duke menduar që kishte bërë kërkesë për heqjen nga shorti për shkak të ngarkesës si anëtare e KED-së. Në kushtet kur anëtarja e KED-së zonja {...} nuk ka bërë kërkesë për t’u përjashtuar nga shorti dhe në kushtet kur referuar vendimit të KLGJ-së, pikës 5, të Kreut VIII i cili thotë “si rregull”, Këshilli nuk është në kushtet e rregullit, pasi ka mungesë të tejskajshme të gjyqtarëve, mendon që kjo kërkesë nuk duhet pranuar.

Zoti Toro: Kundër.

Zonja Luli: Kundër sepse edhe herën e kaluar ka votuar për të njëjtën gjë dhe është e mendimit që nëse do sillet një kërkesë e tillë, duhet të sillet për të tërë anëtarët e KED-së që janë edhe gjyqtarë, d.m.th. nëse duhet të vendoset për të, duhet të vendoset për të gjithë, ose ndryshe, nëse merret individualisht një gjyqtar, duhet të ketë kërkesë.

Zonja Shehu: Kundër.

Zonja Ukperaj: Pro.

Zoti Kurushi: Kundër.

Zoti Rusi: Për shkak të standardit të mbajtur në mbledhjen e kaluar, pro propozimit.

Me shumicë votash nuk pranohet propozimi i zonjës Ukperaj.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë më diskutime apo kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 4, penale, gjyqtarët Ornela Naqellari (relatore), Fatri Islamaj dhe Emona Muçi (anëtarë).

Për çështjen nr. 2, penale, gjyqtarët Fatri Islamaj (relator), Ornela Naqellari dhe Emona Muçi (anëtarë).

Për çështjen nr. 3, penale, gjyqtare Ornela Naqellari.

Për çështjen nr. 1, penale, gjyqtari Fatri Islamaj.

Me përfundimin e procedurave të shortit, mbledhja deklarohet e mbyllur.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor